

VENDIM
Nr. 540, datë 29.7.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PËRFITIMIT, KRITEREVE DHE KUSHTET
E VEÇANTA TË PËRFITIMIT PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE
TË MESME, PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e masës së përfitimit, kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit nga fondi i zhvillimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat zhvillojnë projekte, që nxisin e përmirësojnë digjitalizimin.

2. Termat e përdorur në përmbajtje të këtij vendimi kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

3. Përfitimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nga mbështetja e programeve apo projekteve nga donatorët apo institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për mbulimin e shpenzimeve të projektit, të cilat janë kontribut i vetë kërkuarit dhe nuk mbulohen nga ky fond, nuk përbën pengesë për përfitimin e fondit për të njëjtin projekt.

II. MASA E PËRFITIMIT, KRITERET DHE KUSHTET E VEÇANTA PËR PËRFITIMIN E FONDIT

1. Fondi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, nga buxheti i shtetit për vitin 2022, është në shumën/vlerën 105 000 000 (njëqind e pesë milionë) lekë dhe përballohet në masën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë nga shpenzimet korrente dhe 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekë nga shpenzimet kapitale të programit 04130, “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në varësi të projektit konkurrues të përgatitur nga kërkuari, fondi mbulon 80 (tetëdhjetë) % të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind) lekë.

2. Kërkuari për përfitimin e fondit plotëson kriteret e përgjithshme të përcaktuara në pikën 5, të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe kriteret e veçanta të lidhura me projektplanin e biznesit, si më poshtë vijon:

a) Përputhshmëria e planit të biznesit me objektin dhe qëllimin e dhënies së grantit, duke pasur në fokus nxitjen, përparimin e zhvillimin e proceseve teknologjike dhe treguesve të digjitalizimit;

b) Qartësia, saktësia dhe objektiviteti i planit të biznesit, elemente të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;

c) Qartësia dhe specifikimi konkret i argumentuar i treguesve të digjitalizimit;

ç) Plani konkret dhe i argumentuar, që justifikon rritjen e numrit të të punësuarve në ndërmarrje;

d) Të dhëna konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv në mjedis, produkt i realizimit të projektplanit të biznesit.

3. Aktivitetet e lejuara në projektet e ndërmarrjeve, me qëllim përfitimin e mbështetjes, plotësojnë të paktën një nga këto kushte të veçanta:

a) Blerjen/ndërtimin e pajisjeve/makinerive të reja digjitale/teknologjike;

- b) Blerjen/ndërtimin e aplikacioneve për shërbim klienti apo menaxhim të dhënash;
- c) Ndërtimin e një faqeje *web-i*/platforme *online* për marketingun e kompanisë/biznesit, promovimin e ndërlidhjen me klientët;
- ç) Blerjen/ndërtimin e aplikacioneve/programeve apo paketave të ndryshme të programeve kompjuterike.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama